



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premiera/Office of Prime Minister

Zyra për Çështje të
Komuniteteve/Kancelarijapitanjazajednica/Office
forCommunityAffairs



KONKURS

Zyra e Kryeministrit/Zyra për çështje të komuniteteve, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë, shpall konkurs për organizatat joqeveritare për zbatimin e projektit **"Mbështetje për Zyrën e komuniteteve/Zyra e Kryeministrit të Kosovës."**

QËLLIMI

Projekti ka për qëllim të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të Zyrës së komuniteteve në zbatimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë. Qëllimi i konkursit është zgjedhja e projektit që do të kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve në fushën e zhvillimit të iniciativave të projekteve në sektorë të ndryshëm, siç janë infrastruktura, zhvillimi ekonomik dhe shoqëria civile në qeverisjetlokaletë komuniteteteve joshumicë, duke përfshirë zhvillimin e zgjidhjeve të qëndrueshme në këtë fushë.

PROCESI

ZKM/ ZÇK, nëpërmjet konkursit publik dhe të hapur dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi të Kosovës, e me qëllim zhvillimit të kapaciteteve lokale do të ndajë një grant OJQ-së së zgjedhur. Fituesi i grantit, për të mbështetur zhvillimin e kapaciteteve të qeverisjeve lokale për zhvillimin e iniciativave të projekteve në komunitetet pakicë në Kosovë, do të organizojë një ekip ekspertësh vendorë dhe të koordinatorëve të qeverisjeve lokale i cili do të ketë për qëllim zhvillimin dhe livrimin e dokumenteve të cilësisë së lartë të projekteve (deri në 3 dokumente / deri në 5 komuna) në fushat e sipërpërmendura, në përputhje me prioritetet e qeverisjeve lokale të komuniteteve joshumicë e në përputhje me prioritetet e komunitetit të donatorëve, duke respektuar legjislacionin në fuqi të Kosovës.

Fituesi, gjithashtu në formularin e aplikimit do të propozojë zgjidhje të qëndrueshme për qeverisjet lokale në lidhje me hartimin e dokumenteve me cilësi të lartë të projekteve në formën e strategjisë afatshkurtër dhe të planit.

KRITERET E PËRGJITHSHME TË APLIKIMIT:

1. Tëjetë e regjistruar (të posedojë certifikatëne regjistrimit të Republikës së Kosovës)
2. Numri fiskal
3. Organizata duhet të ketë qe nëparaprakisht aktivem bi 8 vjet

4. Organizata duhet të jetë në gjendje të dëshmojëse ka burime të tjera finaciareo se merrmbështetje nga donator tjetërë
5. Të ketë përvojë pune në fushën e implementimit të dokumenteve të projekteve (p.sh. aplikacionetë EU/USAID/UN) në Kosovë
6. Të ketë përvojë pune me komunat siç janë Graçanica, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Novo Bërdo.
7. Qënëfushën e punës të ketë për qëllim zhvillimin e shoqëris ë civile

FONDI I PROJEKTIT

- ZÇK-ja do të ndajë 26.000 euro nga fondi i alokuar nga Ambasada Norvegjeze, i cili është dedikuar për zhvillimin dhe integrimin e komuniteteve jo shumicë.
- PAGESA do të bëhet në euro kurse transferimi kryhet vetëm nëpërmjet transaksionit bankar.

DOKUMENTACIONI PËRCJELLËS PËR APLIKIM

1. Formulari i kërkesës duhet të plotësohet në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës (Shqip/Serbisht), në formë të përmbledhur me të dhëna të sakta ;
2. Një kopje e letërnjoftimit/pasaportësë vlefshme të Kosovës të personit që përfaqëson organizatën;
3. Certifikata e Regjistrimit e Republikës së Kosovës
4. Certifikata e numrit fiskal
5. Dëshmia se organizata është aktive për më shumë se 8 vjet
6. Dëshmi e tatimit të paguar
7. Kartela bankare e skanuar (në sistemin e Republikës së Kosovës)
8. Dëshmi e përvojës së punës me komunitetet jo shumicë në komunat, siç janë Graçanica, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi
9. Dëshmia e punës me komunitetet joshumicë
10. Që në fushën e punës ka për qëllim zhvillimin e shoqërisë civile

Formulari për aplikim mund të shkarkohet nga: www.kryeministri-ks.net ose www.kryeministri-ks.net/zck

Organizatata që konkurrojnë duhet t i dërgojnë dokumenter e veta (të futura në pliko, në adresën: Rr. Nënë Tereza, Ndërtesa e Qeverisë së Kosovës, kati gjashtë, zyra Nr. 606) ose dokumentet e skanuara t i dërgojnë në email adresën: zck-kpz-grants@rks-gov.net

Afati i aplikimit fillon nga data e publikimit, 15.03.2016 dhe zgjatë 15 (pesembëdhjetë) ditë, deri më 29.03.2016. në orën 16 00.

Brenda 10 ditëve nga data e mbylljes së konkursit, ZÇK do të shqyrtojë aplikacionet e paraqitura dhe do t i njoftojë organizatat që kanë hyrë në rrethin e ngushtë. Zyra për çështje të komuniteteve, pastaj do të formojë një komision i cili do zgjedhë organizatën që do të zbatojë projektin.